

**STATUTI DHE AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR " PENTA CONSULTING sh.p.k"**

Sot më datë 26/06/2023 ortaku i vetëm vendosi të themeloj Shoqërinë "PENTA CONSULTING sh.p.k, Z. Besnik Binjakaj, shtetas shqiptar, atësia Alush, lindur në Selenicë Vlorë, me banim në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, me numer identifikimi ID. G81120113M

Ky Statut është nënshkruar me dëshirën e ortakut të vetëm në Tiranë më 26.06.2023 në katër ekzemplarë origjinalë duke patur fuqi të barabartë ligjore.

**ORTAKU**

**Besnik Binjakaj**

**STATUT DHE AKT THEMELIMI**

**I**

**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**" PENTA CONSULTING sh.p.k"**

Tiranë, më 26/06/2023

+   
ORTAKU I VETËM

# STATUTI

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

### **"PENTA CONSULTING sh.p.k**

#### EMERTIMI-OBJEKTI-QENDRA-KOHEZGJATJA

#### **NENI 1-Emërtimi i shoqërisë**

Shtetasi shqiptar:

Besnik Binjakaj i biri i Alushit, lindur në Vlorë më 20/11/1968 me shtetësi dhe kombësi shqipëtare, dhe banues në Tiranë, në adresën Rr. Selita e vjetër Nr. 1, Ap. 24, është ortak i vetëm i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e quajtur "**PENTA CONSULTING sh.p.k**"  
Shoqëria është person juridik dhe do ushtrojë veprimtarinë në bazë të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 «Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare» i ndryshuar.

#### **NENI 2—Objekti i veprimtarisë së shoqërisë**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do jete si vijon:

- a) Shërbime të konsulences, asistences ekonomiko - financiare dhe investimeve
- b) Aktivitet të konsulences ne pronat e paluajshme
- c) Shërbime import eksport, me automiete ne rruge tokesore, detare dhe ajrore
- d) Shërbime te mjeteve me qira
- e) Manaxhim i fondeve turistike dhr tregtare
- f) Planifikime, ndërtime dhe manaxhimi te objekteve te ndryshme te pasurive te paluajshme
- g) Asistencë përfaqësime për marrjen dhe përdorimin e lejeve/ licensave të ndryshme sipas fushave të veprimtarisë
- h) Ofrimi trajnimeve profesionale në hoteleri – turizëm, sociale, marëdhënie publike dhe ndërkombëtare
- i) Studime / analiza për vlerësimin inxhinierik dhe teknik të pasurive të patundshme publike dhe/ ose private
- j) Të kryejë çdo transaksion në lidhje me pronat e lëvizshme ose reale, si dhe çdo aktivitet tregtar, me qira ose hipotekë, që mund të konsiderohet i nevojshëm ose i dobishëm për të arritur qëllimin e Shoqërisë;
- k) Të fitojë, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, interesa në kompani të tjera që kanë një objekt të ngjashëm me atë të shoqërisë, në Shqipëri ose jashtë saj;
- l) Të kryejë çdo veprimtari tjetër që mund të konsiderohet e dobishme ose e nevojshme për të arritur qëllimin e Shoqërisë.

#### **NENI 3-Kohëzgjatja e veprimtarisë**

Shoqëria do te ushtrojë aktivitetin tregtar do jetë subjekt i të drejtës shqiptare pa afat të përcaktuar. Me vendim te ortakut të vetëm afati i mësipërm mund te ndryshojë ose shoqëria mund të shkrihet.



#### NENI 4-Vula

Shoqëria do të ketë vulën e vet në formën e përcaktuar nga ortaku.

#### NENI 5- Selia e shoqërisë

Shoqëria “**PENTA CONSULTING sh.p.k**” ka qendrën në Tiranë ne adresën Rruga George W. Bush Nr 1, Kati 3, Ap nr 12, njesia Bashkiake Nr 2 Tiranë, (perball Parlamentit) dhe do te ketë të drejtë të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria mund të krijojë agjenci, zyra përfaqësimi, qendra dytësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

#### NENI 6- Kapitali i regjistruar

Kapitali i shoqërisë është LEKE 100.000 (njëqind mijë lekë) dhe është kapital i ortakut të vetëm.

Kapitali është i ndare në 1 kuote me vlere 100.000 lekë (njëqind mijë lekë) dhe zotërohet nga z. Besnik Binjakaj.

Kapitali i shoqërisë mund te rritet apo zvogëlohet me vendim të ortakut të vetëm.

#### NENI 7-Transferimi i kuotave

Kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme.

1.Kuotat e kapitalit të shoqërisë si dhe të drejtat qe rrjedhin prej tyre me vendim të ortakut të vetëm mund te fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- c) dhurimit; (si personave që kanë lidhje gjaku me ortakun e vetëm ashtu edhe të tjerëve pa lidhje gjaku)
- d) çdo mënyre tjetër te parashikuar me ligj.

2. Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

#### NENI 8-Ortaku i vetëm

Shoqëria zotërohet nga një ortak dhe të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë se veprimtarisë;
- Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- Investimet e reja;
- Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria vendos ndryshe.

## NENI 9 – Drejtimi dhe administrimi

9.1 Shoqëria tregtare "**PENTA CONSULTING**" sh.p.k do drejtohet nga një administrator që emërohet me vendim të ortakut të vetëm.

Administrator i Shoqërisë duke filluar nga data e sotme për periudhën në vazhdim (26.06.2023 deri ne 25.06.2024) do të jetë z. Besnik Binjakaj ortaku i vetëm i shoqeris "PENTA CONSULTING" sh.p.k

9.2 Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortakut i vetëm;
- përfaqëson shoqërinë tregtare;
- kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut të vetëm për miratim;
- krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- kryen regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- raporton përpara ortakut të vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

9.3 Ortaku i vetëm mund ta shkarkojë administratorin në çdo kohë. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund ta përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

9.4. Administratori do shpërblehet sipas përcaktimit të ortakut të vetëm në përputhje me parashikimin e nenit 97 te ligjit nr.9901 date 14.04.2008.

9.5 Administratori ka të drejtë të caktojë dhe revokojë persona të tretë ne mungesë dhe për llogari të tij.

## NENI 10 – Kontrolli i brendshëm

Shoqëria tregtare organizon kontrollin e brendshëm me një kontabël të miratuar, i cili është përgjegjës përpara kësaj shoqërie për dëmet që mund të shkaktojë nga moskryerja në rregull e detyrës së tij.

## NENI 11 – Bilanci dhe të ardhurat

Veprimet ekonomike e financiare të shoqërisë mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti përveç rasteve e urdhrave të veçanta të ortakut të vetëm të saj. Në fund të çdo periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabël me rezultatin ekonomik HUMBJE FITIME.

Bilanci kontabël miratohet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës dhe pas përcaktimit të detyrimeve fiskale pjesa që mbetet i jepet për përdorim Ortakut të vetëm të saj.

## NENI 12 – Shpërbërja e shoqërisë

Shpërbërja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak. Në rast shkrirje të shoqërisë,

Ortaku i vetëm vendos mbi mënyrat e likuidimit dhe cakton një ose më shume likuidatorë duke iu përcaktuar edhe detyrat.

Në rastin e likuidimit emërtimi i shoqërisë do të shoqërohet nga shënimi:

**SHOQERI NE LIKUIDIM E SIPER.**

Administratori regjistron prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

### NENI 13 - Dispozita përfundimtare

Për sa nuk është shprehur plotësisht në këtë statut do i referohet plotësimeve të bëra nga ORTAKU I VETEM.

Shoqëria "**PENTA CONSULTING sh.p.k**" Sh.p.k do të jetë subjekt i të drejtës shqiptare dhe do ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me normat e legjislacionit shqiptar në përgjithësi dhe normat e këtij statuti.

Ky statut nënshkruhet prej ortakut në datë 26.06.2023

  
ORTAKU I VETEM